VENDIM
Nr. 552, datë 18.6.2015

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 217, DATË 11.3.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 8.4.2014, PËR ÇËSHTJEN "KARAGJOZI DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË"(PËR ANKIMET NR. 25408/06, 37419/06; 49121/06; 1504/07; 19772/07; 46685/07; 49411/07; 27242/08; 61912/08 DHE 15075/09)"

Në mbështetje të nenit 100të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 217, datë 11.3.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Pas paragrafit të parë, të pikës 1, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 8.4.2014, për çështjen "Karagjozi dhe të tjerë kundër Shqipërisë", për ankimimet nr. 37419/06 (Budini), në shumën 486 234 (katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e tridhjetë e katër) lekë, dhe nr. 1504/07 (Hajnaj), në shumën 135 078 258 (njëqind e tridhjetë e pesë milionë e shtatëdhjetë e tetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e tetë) lekë, plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.".

2. Në pikën 4, fjalët "...dhe Okaj, (nr. 15075/09)..."zëvendësohen me fjalët "...Okaj (nr. 15075/09); Budini (nr. 37419/06) dhe Hajnaj (nr. 1504/07)...".

3. Pas pikës 8, shtohet pika 8/1, me përmbajtjen, si më poshtë vijon:

"8/1 Efekti financiar, i parashikuar në paragrafin e dytë, të pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Financave, në programin "Ekzekutimi i pagesave të ndryshme", përkatësisht, për shumën 25 418 492 (njëzet e pesë milionë e katërqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e dy) lekë,dhe pjesa tjetër të përballohet nga "Fondi i Kontingjencës", përkatësisht, për shumën 110 146 000 (njëqind e dhjetë milionë e njëqind e dyzet e gjashtë mijë) lekë.".

4. Pikat 6 dhe 7 shfuqizohen.

5. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama